



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 22 shkurt 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Selimit për Caktimin e Datës për Paraqitje
Vijuese, Mocione Paraprake dhe për Pezullimin e Afatit të Njoftimit për Alibi**

**Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të
Specializuar**
Aleks Uajting

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II (“Trupi Gjykses”), bazuar në nenet 21, 39(4)-(5), 40(6)(a) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 90, 92(2)(c), 95(2)(f) dhe (5), 97, 98(1) dhe 104 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 26 janar 2023, Trupi Gjykses vendosi të hiqeshin të gjitha redaktimet e versionit të redaktuar konfidencial të aktakuzës së konfirmuar me ndryshime të mëtejshme¹ deri më 27 janar 2023 dhe, rrjedhimisht, urdhëroi Zyrën Administrative të riklasifikonte versionin rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* të aktakuzës në fjalë (“F00999/A01” ose “Aktakuza”) si konfidencial dhe të hiqte statusin e saj *ex parte* deri më të njëjtën datë.²

2. Më 27 janar 2023, F00999/A01, përfshirë përkthimet e saj në shqip dhe serbisht, u riklasifikua si konfidenciale dhe iu hoq statusi *ex parte*.³

3. Më të njëjtën ditë, Trupi Gjykses urdhëroi Mbrojtjen e Hashim Thaçit (“Mbrojtja e Thaçit”), Mbrojtjen e Kadri Veselit (“Mbrojtja e Veselit”), Mbrojtjen e Rexhep Selimit (“Mbrojtja e Selimit”) dhe Mbrojtjen e Jakup Krasniqit (bashkërisht, “të akuzuarit” dhe “Mbrojtja”), të dorëzonin, deri më 15 shkurt 2023, ora 16:00, dhe në pajtim me rregullat 95(5) dhe 104(1)(a), njoftimet për alibi,

¹ F00999/A02, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 2 e Parashtrimit të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar*, 30 shtator 2022, konfidenciale.

² F01229, Trupi Gjykses II, *Vendim mbi Redaktime të Aktakuzës*, 26 janar 2023, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 40(a); versioni i redaktuar konfidencial është dorëzuar më 27 janar 2023, F01229/CONF/RED.

³ F01239, Zyra Administrative (Njësia për Administrimin e Gjykatës), *Memorandum sipas Versionit të Redaktuar Konfidencial të Vendimit mbi Redaktime të Aktakuzës*, F1229, 30 janar 2023, konfidencial.

përkatësisht të ndryshonin ose të plotësonin njoftimet ekzistuese për alibi, sipas rastit.⁴

4. Më 13 shkurt 2023, Mbrojtja e Selimit dorëzoi një kërkesë⁵ ("Kërkesa e Selimit") me të cilën i kërkonte Trupit Gjykes: (i) ta ftonte Gjykatësin e Procedurës Paraprake të caktonte datën e një paraqitjeje vijuese lidhur me pretendimet, të cilave rishtazi iu hoqën redaktimet, kundër z. Selimi në paragrafët 41, 42, 49, 115, 139 dhe 149 të Aktakuzës (përkatësisht, "pretendimet e çredaktuara" dhe "kërkesa e parë"); (ii) të caktonte datën për dorëzimin e mocioneve paraprake të Mbrojtjes lidhur me pretendimet e çredaktuara jo më herët se më 20 shkurt 2023 ("kërkesa e dytë"); dhe (iii) të pezullonte afatin për dorëzimin e njoftimit të përditësuar për alibi deri pas trajtimit të mocioneve paraprake të dorëzuara në lidhje me pretendimet e çredaktuara ("kërkesa e tretë").⁶

5. Më 15 shkurt 2023, gjatë konferencës përgatitore të Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS"), Mbrojtja e Selimit u pyet nëse i qëndronte Kërkesës së vet, të cilën ajo e konfirmoi,⁷ dhe bëri me dije se synonte të dorëzonte mocione paraprake lidhur me të deri më 24 shkurt 2023.⁸

6. Më të njëjtën ditë, Mbrojtja e Thaçit, Mbrojtja e Veselit dhe Mbrojtja e Selimit dorëzuan njoftime të mëtejshme për alibi.⁹

⁴ F01231, Trupi Gjykes II, *Urdhër mbi Njoftim të Mëtejshëm për Alibi dhe Nxjerrje të Materialeve Përkatëse*, 27 janar 2023, konfidencial, para. 19(a)-(b).

⁵ F01281, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Mbrojtjes së Selimit për Caktimin e Datës nga Trupi Gjykes për Paraqitje Vijuese dhe Mocione Paraprake dhe për Pezullimin e Urdhrit për Përditësimin e Njoftimit për Alibi*, 13 shkurt 2023.

⁶ Kërkesa e Selimit, para. 1-2, 31.

⁷ Versioni jopërfundimtar i transkriptit të seancës, 15 shkurt 2023, f. 2034, rreshti 13 deri f. 2035, rreshti 7.

⁸ Versioni jopërfundimtar i transkriptit të seancës, 15 shkurt 2023, f. 2037, rreshtat 17-20 dhe f. 2038, rreshtat 4-6.

⁹ F01294, Mbrojtësi i Specializuar, *Njoftim i Mëtejshëm i Mbrojtjes së Thaçit për Alibi*, 15 shkurt 2023; F01297, Mbrojtësi i Specializuar, *Njoftim Plotësues i Mbrojtjes së Veselit për Alibi*, 15 shkurt 2023, konfidencial; F01298, Mbrojtësi i Specializuar, *Njoftim i Përditësuar i Mbrojtjes së Selimit për Alibi*, 15 shkurt 2023.

7. Më 20 shkurt 2023, ZPS-ja u përgjigj ndaj Kërkesës së Selimit (“Përgjigjja e ZPS-së”).¹⁰

8. Mbrojtja e Selimit bëri të ditur me anë të postës elektronike më 20 shkurt 2023 se nuk do t’i kundërpërgjigjej Përgjigjes së ZPS-së.¹¹

II. PARASHTRIMET

9. Mbrojtja e Selimit parashtron se heqja e redaktimeve në Aktakuzë kishte si efekt praktik nxjerrjen në pah të disa pretendimeve të reja kundër z. Selimi të cilat, faktikisht, përbënin “akuza të reja” sipas rregullës 90(2).¹² Në veçanti, Mbrojtja e Selimit vë në dukje pjesë të paragrafëve 41, 42, 49, 115, 139 dhe 149 të Aktakuzës prej të cilave janë hequr redaktimet rishtazi.¹³ Bazuar mbi këtë, dhe që të garantohet e drejta e gjykimit të drejtë për z. Selimi,¹⁴ Mbrojtja e Selimit i kërkon Trupit Gjykses ta ftojë Gjykatësin e Procedurës Paraprake të caktojë datën për një paraqitje vijuese të z. Selimi lidhur me pretendimet e çredaktuara,¹⁵ të caktojë datën për dorëzimin e mocioneve paraprake sipas rregullës 90(4)¹⁶ dhe të pezullojë afatin e caktuar nga Trupi Gjykses për dorëzimin e njoftimeve të ndryshuara për alibi nga ana e Mbrojtjes.¹⁷

10. ZPS-ja përgjigjet se duhet të rrëzohet Kërkesa e Selimit¹⁸ pasi pjesët pa redaktime të aktakuzës nuk përbëjnë “akuza të reja” dhe, për pasojë, nuk ekziston e drejta për një paraqitje vijuese, as për mocione paraprake.¹⁹ Në veçanti, ZPS-ja

¹⁰ F01307, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes së Selimit për Caktimin e Datës për Paraqitje Vijuese dhe Mjete Juridike Përkatëse Lidhura me Të (F01281)*, 20 shkurt 2023.

¹¹ CRSPD180, *Mesazh Elektronik nga Mbrojtja e Selimit për NJAGJ-në lidhur me Kundërpërgjigjen ndaj Parashtrimit të Protokolluar F01307*, 20 shkurt 2023.

¹² *Shih veçanërisht*, Kërkesën e Selimit, para. 2, 4-5, 7.

¹³ Kërkesa e Selimit, para. 1.

¹⁴ Kërkesa e Selimit, para. 2, 9, 30.

¹⁵ Kërkesa e Selimit, para. 10-13, 31(i).

¹⁶ Kërkesa e Selimit, para. 14-20, 31(ii).

¹⁷ Kërkesa e Selimit, para. 21-27, 31(iii).

¹⁸ Përgjigjja e ZPS-së, para. 1, 5.

¹⁹ Përgjigjja e ZPS-së, veçanërisht, para. 1-3.

parashtron se të akuzuarit nuk akuzohen për kryerjen e drejtpërdrejtë të ndonjërit prej krimeve të paraqitura në aktakuzë po për kontributin (përfshirë edhe pjesëmarrjen personale në krime) në kryerjen e krimeve përmes ndërmarjes kriminale të përbashkët.²⁰ Në këtë kontekst, pjesët e paredaktuara të aktakuzës nuk duhet të kuptohen si akuza shtesë, po si fakte juridikisht thelbësore për të provuar krimet e paraqitura dhe format e përgjegjesisë të lidhura me to.²¹ Sipas ZPS-së, kërkesa e tretë është e pabazuar.²²

III. DISKUTIM

A. KËRKESA E PARË DHE KËRKESA E DYTË

11. Paraprakisht, Trupit Gjykses i duhet të përcaktojë nëse pretendimet e çredaktuara përbëjnë “akuza të reja” siç pretendon Mbrojtja e Selimit. Në rast se nuk është kështu, nuk ka arsye të vlefshme sipas Ligjit dhe Rregullores për miratimin e mjeteve juridike të kërkuara nga Mbrojtja.

12. Neni 39, paragrafi 8, i Ligjit përcakton se:

Pasi të jetë konfirmuar aktakuza por para se të ketë filluar shqyrtimi gjyqësor, Prokurori i Specializuar mund ta ndryshojë aktakuzën me lejen e Gjykatësit të Procedurës Paraprake (ose të Trupit Gjykses nëse është i informuar) pasi t'i ketë dëgjuar palët. Nëse Prokurori i Specializuar kërkon të shtojë akuza të tjera, apo t'i zëvendësojë akuzat më të rënda, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i shqyrton ato akuza dhe e mban shqyrtimin fillestar në pajtim me këtë nen.

Në Ligj nuk përmendet askund tjetër nocioni i “akuzave të reja” .

²⁰ Përgjigjja e ZPS-së, para. 2.

²¹ Përgjigjja e ZPS-së, para. 2. *Shih gjithashtu* versionin jopërfundimtar të transkriptit të seancës, 15 shkurt 2023, f. 2035, rreshti 23 deri f. 2036, rreshti 4 dhe f. 2036, rreshti 18 deri f. 2037, rreshti 1.

²² Përgjigjja e ZPS-së, para. 1.

13. Për sa i përket Rregullores, “akuzat e reja” përmenden tri herë, në rregullën 90 me titullin “Ndryshimi i aktakuzës”.²³ Sipas neneve 39(8) dhe 40(7) dhe rregullës 90, pas konfirmimit të akuzave, ndryshimi i aktakuzës mund të bëhet duke kërkuar leje nga Trupi Gjykes dhe duke marrë miratim prej e tij.

14. Nga sa më sipër, është e qartë se korniza ligjore e Dhomave të Specializuara (“DHS”) parasheh se “akuzat e reja”, pra akuzat që nuk përfshiheshin në aktakuzën fillestare të konfirmuar, janë vetëm ato të cilat rrjedhin nga një proces i autorizuar gjyqësor për ndryshimin e aktakuzës. Vetëm në këto raste kërkohet një paraqitje vijuese²⁴ dhe vetëm atëherë ndryshohen afatet e mocioneve paraprake.²⁵

15. Për këto arsye, Trupi Gjykes arrin në përfundimin se heqja e redaktimeve nga aktakuza e kësaj çështjeje gjyqësore nuk përbën apo rezulton në “akuza të reja” sipas kuptimit të kornizës ligjore të DHS-së.

16. Për më tepër, edhe nëse supozohet se korniza ligjore e DHS-së përmban nocionin e “akuzave të reja” edhe kur nuk bëhet ndryshim zyrtar i aktakuzës, pretendimet e çredaktuara përsëri nuk do të përbënin “akuza të reja” në kuptimin juridik të fjalës. Sipas standardit të zbatueshëm, “akuzë e re” është ajo e cila paraqet një bazë të re fajësie që nuk ishte pasqyruar në aktakuzë më parë dhe e cila është e dallueshme nga pikëpamja faktike apo ligjore nga çdo bazë tjetër e paraqitur në aktakuzë deri në atë moment.²⁶

²³ Shih rregullën 90, para. 2-4.

²⁴ Rregulla 90(3).

²⁵ Rregulla 90(4). Shih gjithashtu ICTY, *Prosecutor v. Delić*, IT-04-83-PT, *Decision on the Prosecution’s Submission of Proposed Amended Indictment and Defence Motion Alleging Defects in Amended Indictment*, 30 June 2006, para. 22; *Prosecutor v. Halilović*, IT-01-48-PT, *Decision on Prosecutor’s Motion Seeking Leave to Amend the Indictment*, 17 December 2004, in particular, paras 22 ff.; *Prosecutor v. Stanišić and Župljanin*, IT-08-91-PT, *Decision on Motion and Supplementary Motion for Leave to Amend the Indictment*, 28 April 2009, para. 14.

²⁶ IA018-F00007, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelet e Mbrojtjes kundër Vendimit lidhur me Kërkesën për Ndryshimin e Aktakuzës sipas Rregullës 90(1)(b) të Rregullores (“Vendimi i Apelit i 22 marsit”)*, 22 mars 2022, para. 24. Shih gjithashtu, p.sh., ICTY, *Prosecutor v. Stanišić & Simatović*, IT-03-69-PT, *Decision on Prosecution Motion for Leave to Amend the Amended Indictment*, 16 December 2005, p. 4; *Prosecutor v. Marijačić & Rebić*, IT-95-14-R77.2, *Decision on Prosecution’s Motions to Amend the Indictment*, 7 October 2005, para. 29; *Prosecutor v. Popovic et al.*, IT-05-88-PT, *Decision on Further Amendments and*

17. Në rastin konkret, pretendimet e çredaktuara nuk përbëjnë “akuzë të reja” të mëvetësishme sipas standardeve të zbatueshme. Përkundrazi, siç e ka bërë të qartë ZPS-ja, ato janë pretendime faktike dhe pjesë e një matrice faktike më të gjerë e cila përbën akuzë në Aktakuzë.²⁷ Për shembull, paragrafët 41, 42 dhe 49 të Aktakuzës (përfshirë pjesët e tyre të paredaktuara) paraqesin hollësi të mëtejshme se si të akuzuarit pretendohet të kenë qenë pjesë e ndërmarrjes kriminale të përbashkët për kryerjen e krimeve të paraqitura në aktakuzë, dhe/ose të kenë ndihmuar apo inkurajuar këto krime, në vende të ndryshme gjatë periudhës që mbulon Aktakuza. Pjesët të cilave u janë hequr redaktimet rishtazi përbëjnë thjesht hollësi të mëtejshme faktike të pretendimeve ekzistuese, për të cilat të akuzuarit kanë dijeni tashmë, lidhur me pjesëmarrjen e tyre të pretenduar në kryerjen e krimeve të paraqitura në aktakuzë.²⁸ Për më tepër, Trupi Gjykes rikujton se: (i) paragrafi 42 i aktakuzës u analizua më parë për të parë nëse përbënte akuzë të re; (ii) Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se nuk ishte akuzë e re; dhe (iii) ky konstatim u konfirmua në apel.²⁹

18. Në mënyrë të ngjashme, pretendimet të cilave u janë hequr redaktimet rishtazi në paragrafin 115 të Aktakuzës janë pjesë e një akuze ekzistuese të “akteve të tjera çnjerezore dhe trajtimit mizor” që pretendohet të kenë kryer të akuzuarit gjatë periudhës së aktakuzës në vende të ndryshme, përfshirë në Kleçkë, midis të paktën nëntorit 1998 dhe qershorit 1999. Ato nuk janë pretendime të mëvetësishme të cilat do të përbënin bazë të re fajësie sipas kuptimit të “akuzave të reja” të

Challenges to the Indictment, 13 July 2006, para. 11; *Prosecutor v. Šešelj et al.*, IT-95-14-R77.5, *Decision on Prosecution Motion to Amend the Indictments*, 8 June 2006, para. 12; *Prokurori kundër Haradinajt e të tjerëve*, IT-04-84-PT, *Vendim mbi Mocionin për Ndryshimin e Aktakuzës dhe mbi Kundërshtimet ndaj Formës së Aktakuzës së Ndryshuar*, 25 tetor 2006, para. 13; *Prosecutor v. Beara*, IT-02-58-PT, *Decision on Prosecution Motion to Amend the Indictment*, 24 March 2005, p. 3.

²⁷ Versioni i parë i transkriptit të seancës, 15 shkurt 2023, f. 2035, rreshti 23 deri f. 2036, rreshti 4 dhe f. 2036, rreshti 18 deri f. 2037, rreshti 1.

²⁸ *Shih* F00635, *Vendim lidhur me Parashtrimin e Aktakuzës së Korrigjuar dhe Kërkesën për Ndryshim sipas Rregullës 90(1)(b) (“Vendimi i 23 dhjetorit 2021”)*, 23 dhjetor 2021, konfidencial, para. 26; versioni i redaktuar publik u lëshua më 14 shkurt 2022, F00635/RED.

²⁹ *Shih* Vendimin e 23 dhjetorit 2021, para. 26. *Shih gjithashtu* Vendimin e Apelit të 22 marsit, para. 15, 22-29.

përkufizuar më lart. Kjo vlen edhe për pretendimet të cilave u janë hequr redaktimet rishtazi në paragrafët 139 dhe 149 të aktakuzës lidhur me vrasjet e paligjshme që pretendohet të kenë kryer të akuzuarit në vende të ndryshme, përfshirë në Likoc dhe Drenoc, gjatë periudhës së Aktakuzës.

19. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykes konstaton se pretendimet e çredaktuara nuk përbëjnë “akuza të reja” për sa i përket këtij procesi gjyqësor.

20. Në përputhje me rregullën 90(2)-(3), nuk ka arsytim të vlefshëm ligjor për një paraqitje vijuese të të akuzuarit ose për afate të reja për dorëzimin e mocioneve paraprake nga ana e Mbrojtjes. Për këtë arsye, as Mbrojtja e Selimit dhe asnjë nga ekipet e tjera të Mbrojtjes nuk autorizohen në bazë të Ligjit apo të Rregullores të dorëzojnë mocione paraprake lidhur me pretendimet e çredaktuara. Sugjerimi i Mbrojtjes së Selimit se redaktimet e urdhëruara të kësaj çështjeje gjyqësore mund të përbëjnë abuzim të procesit³⁰ është i pabazë dhe, rrjedhimisht, hidhet poshtë gjithashtu.

21. Për më tepër, është thjesht i gabuar sugjerimi i Mbrojtjes së Selimit se Trupi Gjykes, gjatë konferencës së ZPS-së, “u pajtua” që Mbrojtja e Selimit të dorëzonte mocione paraprake³¹. Trupi Gjykes nuk la të kuptohet një gjë e tillë por thjesht dëgjoi dhe mbajti shënim njoftimin e Mbrojtjes së Selimit la se planifikonte ta bënte një gjë të tillë. Gjithashtu, Trupi Gjykes vëren se Rregullorja nuk i jep kompetencë Trupit Gjykes për të vendosur nëse duhet të dorëzohen mocione paraprake dhe kur; një gjë e tillë përcaktohet vetëm nga Ligji dhe Rregullorja. Së në fund, Mbrojtja e Selimit duhet ta ketë ditur se mundësia për të dorëzuar mocione të tilla ishte në varësi të konstatimit paraprak nga ana e Trupit Gjykes se pjesët e paredaktuara të aktakuzës përbënin “akuza të reja” sipas Rregullores, gjë që Trupi Gjykes ka konstatuar se nuk përbëjnë.

³⁰ Kërkesa e Selimit, para. 16-17.

³¹ CRSPD180, *Mesazh Elektronik nga Mbrojtja e Selimit për NJAGJ-në lidhur me Kundërpërgjigjen ndaj Parashtrimit të Protokolluar F01307*, 20 shkurt 2023.

22. Rrjedhimisht, hidhen poshtë Kërkesa e Parë dhe Kërkesa e Dytë.

B. KËRKESA E TRETË

23. Për arsyet e paraqitura më lart lidhur me Kërkesën e Parë dhe të Dytë, nuk arsyetohet as Kërkesa e Tretë. Sidoqoftë, kërkesa e tretë është e tejkualuar pasi ka kaluar afati i njoftimeve të mëtejshme për alibi, dhe ekipet e Mbrojtjes i dorëzuan këtë njoftim më 15 shkurt 2023.³²

24. Rrjedhimisht, hidhet poshtë edhe Kërkesa e Tretë.

C. VETËDEKLARIMI I INFORMUAR MBI FAJËSINË OSE PAFAJËSINË

25. Neni 39(5) dhe rregulla 124(3) e bëjnë të qartë se gjykatësi kompetent duhet të bindet që i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën para se t'i kërkojë të deklarohet nëse është fajtor apo jo. Në rastet kur gjykatësi nuk është bindur se vetëdeklarimi është bërë pasi i akuzuari e ka kuptuar atë, gjykatësi mund të mos e pranojë vetëdeklarimin e fajësisë dhe, në vend të kësaj, bën vetëdeklarim në emër të të akuzuarit se është i pafajshëm.³³

26. Në rastin konkret, dhe për shkak të redaktimeve të aktakuzës në kohën e paraqitjes së parë të z. Selimi më 11 nëntor 2020 dhe paraqitjes vijuese më 10 maj 2022, ai mund të mos ketë qenë në gjendje të bëjë deklaram plotësisht të informuar lidhur me ato elemente të akuzave që ishin të redaktuara në atë kohë.³⁴ Trupi Gjykses vëren, gjithsesi, se z. Selimi është vetëdeklaruar i pafajshëm për të gjitha akuzat.³⁵

³² *Shih më lart*, para. 6.

³³ Për ilustrim, *shih, p.sh.*, ICTY, *Prosecutor v. Dragoljub Kunarac*, IT-96-23, Transcripts of 9, 10 and 13 March 1998. *Shih gjithashtu* rregullën 94.

³⁴ Transkript i Seancës, 11 nëntor 2020; Transkript i Seancës, 10 maj 2022.

³⁵ *Shih* Transkriptin e seancës, 11 nëntor 2020, veçanërisht para. 87, 89, 91-92; Transkriptin e seancës, 10 maj 2022, veçanërisht para. 1212, 1215, 1216.

27. Duke pasur parasysh se disa nga pretendimet rreth të cilave ka bërë vetëdeklarim fajësie ose pafajësie i akuzuari kanë qenë të redaktuara në atë kohë, Trupi Gjykes është i mendimit se drejtësia kërkon që t'i jepet z. Selimi mundësia ta ndryshojë vetëdeklarimin e fajësisë apo pafajësisë, në rast se dëshiron ta bëjë një gjë të tillë, tani që ka pasur rastin ta lexojë aktakuzën pa asnjë redaktim. Gjithashtu, Trupi Gjykes mendon se e njëjta mundësi duhet t'u ofrohet edhe tre të akuzuarve të tjerë.

28. Neni 40(6)(a) përcakton se Trupi Gjykes mund të ushtrojë çdo funksion ose kompetencë të Gjykatësit të Procedurës Paraprake që parasheh neni 39(5). Nga ana e saj, rregulla 124(3), përcakton që Kryegjykatësi i Trupit Gjykes duhet të bindet që i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe duhet t'i jepet të akuzuarit mundësia që të konfirmojë deklarimin e vet fillestar në lidhje me fajësinë ose pafajësinë.

29. Trupi Gjykes e kupton se aktakuza pa redaktime u është dorëzuar të akuzuarve më 27 janar 2023 në pajtim me rregullën 87. Trupi Gjykes urdhëron Mbrojtjen t'i këshillojë të akuzuarit për të drejtat e tyre lidhur me pretendimet e çredaktuara me qëllim që ata të vendosin nëse dëshirojnë të ndryshojnë vetëdeklarimet e veta fillestare në lidhje me fajësinë ose pafajësinë në momentin e hapjes së gjykimit. Në rast se vendosin të mos e bëjnë një gjë të tillë, në pajtim me nenin 40(6)(a) dhe rregullën 92(2)(f), Trupi Gjykes bën deklarimin e pafajësisë në emër të secilit prej të akuzuarve.

IV. VENDIM

30. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykes:

(a) **RRËZON** Kërkesën e Selimit në tërësi;

- (b) **NUK AUTORIZON** Mbrojtjen e Selimit, dhe asnjërin nga ekipet e tjera të Mbrojtjes, të dorëzojnë mocione paraprake lidhur me pretendimet e çredaktuara;
- (c) **URDHËRON** Mbrojtjen të sigurohet që të akuzuarit janë këshilluar për të drejtat e tyre lidhur me pretendimet e çredaktuara për t'iu mundësuar të vendosin nëse dëshirojnë të ndryshojnë deklaratimet e veta fillestare si të pafajshëm (që ka bërë në emrin e tyre Gjykatësi i Procedurës Paraprake, sipas rastit); dhe
- (d) **INFORMON** të akuzuarit se, në pajtim me rregullën 124(3), do t'u jepet mundësia të ndryshojnë deklaratimet e veta të pafajësisë (që ka bërë në emrin e tyre Gjykatësi i Procedurës Paraprake, sipas rastit) lidhur me pretendimet e çredaktuara në fillim të gjykimit.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E mërkurë, 22 shkurt 2023

Në Hagë, Holandë.